



Një Ramazan
NDRYSHE

HOXHË ENIS RAMA

PËRMBAJTJA

Drejt një Ramazani më cilësor	2
Si ta ruajmë kualitetin e Ramazanit	7
Fletanketa	14



Qendra për Studim dhe Ndryshim Individual
Prishtinë

DREJT NJË RAMAZANI MË CILËSOR

Mund të thuhet se mundësitë të cilat Allahu ﷻ na i ka dhënë për t'i shfrytëzuar gjatë vitit të gjitha janë të përmblendhura në muajin Ramazan. Kështu, në qoftë se njeriu e shfrytëzon Ramazanim si duhet, ajo çfarë mund t'i ikën pas tij mund të përballohet më lehtë.

Sa më të qartë që njeriu ta ketë qëllimin, aq më sigurt do të vazhdojë drejt tij. Fatkeqësia dhe problemi i shumë prej nesh si muslimanë është se, pas përfundimit të Ramazanit, gjithmonë ndiejmë keqardhje dhe kemi brengën se mos edhe ky Ramazan shkoi sikurse i kaluari.

A kemi bërë ndonjë analizë pse në Ramazanim e kaluar nuk është plotësuar norma e adhurimit dhe ndoshta nuk është arritur qëllimi i kërkuar as përgjysmë sa është synuar, apo të gjitha këto i kemi kapërcyer me një **“hajr in sha Allah”** dhe kemi vënë shpresat në Ramazanim e radhës.

A e ke të qartë çfarë dëshiron në këtë Ramazan? Pse duhet t'i gëzohemi këtij muaji? Përse duhet të përmallohem për këtë muaj? Cilat janë arsyet? Apo e vetmja arsye është ajo e shpërblimit të agjërit, namazit të teravive, etj?

Dua t'i përmendi tri objektiva madhore, të cilat duhet t'i synojmë në muajin Ramazan dhe për të cilat shpresoj se, me lejen e Allahut të madhëruar, do të rrisin kualitetin e veprave tona. Kjo meqë ngecja apo problemi ynë qëndron te kualiteti i veprave që bëjmë, gjë që i jep kuptim adhurimit tonë që i bëjmë Allahut ﷻ

Pra, çfarë duhet synuar për të qenë Ramazani i këtij viti më kualitativ?

1. Rëndësia e përmirësimit të gjendjes sonë të tanishme

Duhet të bëjmë një ndërlidhje të fuqishme, të pa shpëputur mes gjërave, një lidhje shkak-pasojë, çka edhe është ligji i Allahut ﷻ. Në qoftë se si rezultat i këtij Ramazani përmirësojmë vetët tona, atëherë shkak i këtij përmirësimi do të jetë kualiteti i Ramazanit. Sa më kualitativ që të jetë Ramazani, aq më e lartë do të jetë shkalla e përmirësimit. Merre këtë fakt seriozisht: nuk ka përmirësim të gjendjes, në qoftë se kualiteti mbetet në shkallën e vitit të kaluar.

Kur them nuk ka përmirësim të gjendjes, kjo nuk nënkupton ngeljen në shkallën e tanishme, sepse shansi i pashfrytëzuar të zbret më poshtë nga ku ke qenë deri tani. Kjo ngase, sipas ligjit të Allahut ﷻ, nuk e kemi luksin e qëndrimit në të njëjtën shkallë; në qoftë se nuk ecim përpara, së paku do të mbetemi aty ku kemi qenë, gjë që nënkupton humbje. Prandaj, për ta bërë këtë Ramazan sa më kualitativ, duhet të kuptosh se ky synim është i ndërlidhur me përmirësimin që ti e vajton pas çdo Ramazani.

Erdhi shansi që në këtë Ramazan t'ia dëshmojmë Allahut ﷻ se vajtimi jonë i vitit të kaluar dhe keqardhja për gjendjen tonë ishte i sinqertë. Ne duhet të investojmë ende që t'i japim fund udhëheqjes së epshit e udhëheqjes së shejtanit në jetët tona, në mënyrë që zemrat tona, me të vërtetë, të rimarrin udhëheqjen e vetëve tona. Që zemra të marrë këtë udhëheqje, duhet të përmirësohet, ngase në gjendjen që është nuk ka mundësi për të udhëhequr.

Padrejtësia që ia bëjmë vetëve tona duke bërë gjynahe duhet të marrë fund. Në vend të saj, duhet të instalojmë një sistem që nuk na çon në padrejtësi.

Por, nuk do të mund ta kryejmë luftimin e padrejtësisë ndaj vetëve tona dhe as të instalojmë sistemin e drejtësisë në vetët tona, në qoftë se nuk përmirësohemi.

Krejt kjo kërkon që të jesh i aftë, kurse ne ende nuk e kemi aftësinë e duhur për t'i udhëhequr vetët tona atje ku duhet. Për shembull, a ke mundësi të krenohesh për një adhurim nafile që ti e kryen në vazhdimësi prej kohësh? Apo e fillojmë, pastaj rrëzohemi; shkojmë deri diku, pastaj ndalemi. Krejt kjo ndodh për shkak se nuk udhëheqim me vetët tona. Sa e sa herë ke dëgjuar se sa mirë është ta bësh këtë apo atë punë dhe ke vendosur ta bësh, mirëpo nuk ka shkuar java dhe e ke ndërprerë, apo ndoshta edhe nuk e ke filluar fare.

Nëse analizojmë gjendjen tonë, shohim se nuk udhëheqim me vetët tona. Prandaj, është mirë të reflektojmë për gjendjen tonë dhe të vetëdijësohemi për atë se kush po na udhëheq dhe ta përmirësojmë këtë gjendje duke e luftuar padrejtësinë, me qëllim që ta rimarrim pushtetin e vetëve tona.

Ibn Kajimi erdhi në përfundim se "... njeriut ia ka marrë pushtetin nefsi". Nefsi është gjenerali i rebeluar i zemrës. Zemra është udhëheqësi dhe e ka ushtrinë e vet, por nefsi është ushtari më i rebeluar i zemrës, i cili pret edhe shfaqjen e dobësisë më të vogël për ta zëvendësuar me pushtetin e tij. Sa e sa dobësi ka që nefsi i sheh në zemrat tona dhe i shfrytëzon ato për të na udhëhequr aty ku nuk duhet.

Por, ja që është duke ardhur Ramazani për t'ia rikthyer pushtetin kësaj zemre duke e përmirësuar atë. Andaj, në qoftë se lidhim fuqimisht shkakun dhe pasojën - shkaku është adhurimi, pasoja është përmirësimi ynë - me kuptimet të cilat u përmendën, do të kemi një Ramazan më ndryshe. Sa më i zbehtë dhe i paqartë të jetë shkaku, aq do të jetë e paqartë edhe pasoja. Sa më e dobët të jetë nevoja e brendshme për përmirësim, aq më i dobët do të jetë kualiteti i përmirësimit. Pra, lidhini këto dyja.

2. A je i vetëdijshëm kujt po ia kushton veprat të cilat mendon t'i kryesh në këtë Ramazan?

Shpeshherë, të preokupuar me vetë veprën, me barrën e saj, me mënyrën si do ta kryejmë atë, harrojmë t'ua kujtojmë vetëve tona për kë jemi duke e bërë atë veprë. A e di ti kush është duke të përcjellë çfarë je duke bërë gjatë Ramazanit (edhe jashtë tij)? A e di ti kush është duke e vlerësuar kualitetin e agjërit tënd, namazit tënd, dhikrit tënd?

وَمَا تَكُونُ فِي شَأْنٍ وَمَا تَتْلُو مِنْهُ مِنْ قُرْآنٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا إِذْ تُفِيضُونَ فِيهِ ۚ وَما يُعْزُبُ عَنْ رَبِّكَ مِنْ مِثْقَالِ ذَرَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَلَا أَصْغَرَ مِنْ ذَلِكَ وَلَا أَكْبَرَ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٦١﴾

“Ti nuk angazhohesh në asnjë çështje, nuk lexon pjesë nga Kur’ani dhe nuk bën ndonjë veprë, vetëm se Ne jemi dëshmitar, kur ju e ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t’i fshihet asnjë grimcë në tokë a në qiell, as diçka më e vogël e as më e madhe e të mos jetë (evidentuar) në Librin e qartë”. (Junus, 61)

Pra, kjo është një pikë e rëndësishme përmes së cilës besimtarit do t’i mundësohet të jetë më i përgjegjshëm në këtë Ramazan.

Në çdo aspekt të jetës së tij njeriu ka nevojë për përgatitje. Në qoftë se paralajmërohet për ardhjen e mysafirëve, përgatitesh. Dhe sa më i rëndësishëm që të jetë mysafiri, aq më e lartë do të jetë shkalla e përgatitjes. Për çdo gjë në këtë botë puna qëndron kështu, ndonëse për punët e botës tjetër njerëzit nuk përgatiten as 10% nga sa përgatiten për punët e kësaj bote.

Mendoj se ndjenja e besimtarit se Allahu ﷻ është duke e përcjellë bën që veprat e tij të jenë më kualitative. Në anën tjetër, mungesa e ndjenjës së mbikëqyrjes së Allahut ﷻ bën që të humbasë kualitetin e veprave tona. Andaj, të kërkojmë një Ramazan kualitativ, të shkaktuar nga ndjenja e përcjelljes dhe e vëzhgimit të Allahut ﷻ mbi ne.

3. A do ta kemi të lehtë t’i përkushtohemi kualitetit të adhurimit në Ramazan?

A është rruga drejt adhurimit kualitativ e shtruar dhe e rrahur, apo ka pengesa në të?

Ti mund ta dëshirosh përmirësimin, madje mund ta kesh të fortë ndjenjën se Allahu ﷻ është duke të përcjellë, por mos mendo se të gjitha këto do të kalojnë me lehtësi. Patjetër që do të ketë pengesa. Në fakt, këto pengesa janë të metat e nefsit tënd, të cilat që nuk i vë në pah asgjë tjetër veç përpjekjes për të qenë i mirë.

Sa e sa të meta ka në nefsin e njeriut për të cilat ai kurrë s'do të dijë! Sa e sa pengesa ka nga nefsi dhe nga shejtani të cilat asnjëherë nuk i merr vesh, derisa të synosh ta bësh adhurimin më kualitativ. Ndoshta, për llojin e leximit të Kur'anit që tani ti bën shejtani nuk do të të shqetësojë shumë. Apo për llojin e namazit që ti bën nefsi nuk të shqetëson shumë, meqë ka njëfarëlloj “marrëveshje” mes teje dhe nefsit që ky lloj të jetë i pranueshëm. Mirëpo, në qoftë se ti e cenon këtë “marrëveshje” duke synuar përmirësim të kualitetit, do ta shohësh reagimin. Por, kjo nuk duhet të na zmbraps dhe as të na zhgënjëjë, sepse, nëse nuk na shfaqen të metat sot, patjetër do të na shfaqen nesër. Në qoftë se të metat tona nuk i nxjerrë në pah fuqia e kualitetit të adhurimit, do t'i nxjerrë fuqia e Zjarrit të Xhehenemit. Ty të takon të zgjedhësh se me çfarë do t'i nxjerrësh të metat e tua.

يَوْمَئِذٍ تُعْرَضُونَ لَا تَخْفَى مِنْكُمْ خَافِيَةٌ ﴿١٨﴾

“Atë ditë ju do të ekspozoheni (para Zotit) duke mos mbetur i fshehur asnjë sekret juaj!”.
(el-Hakka, 18)

Ndoshta, gjëja më e frikshme për Selefët lidhur me Ditën e Gjykimit ishte befasia. Shumë prej tyre kalonin kohë të gjata në adhurim dukë qarë e duke medituar për ajetin:

وَبَدَا لَهُمْ مِنَ اللَّهِ مَا لَمْ يَكُونُوا يَحْتَسِبُونَ ﴿٤٧﴾

“Prej Allahut do t'u prezantohet ajo që ata nuk e llogaritin”. (Zumer, 47)

Pra, Allahu ﷻ do të ta shfaqë atë që ti nuk ke dashur të shfaqet prej teje në këtë botë. E, tash ti zgjedh ose ta shfaqësh vetë, ose të ta shfaqë Allahu ﷻ.

Kuptoni, vëlla dhe motër e nderuar, se kualiteti i adhurimit garanton shfaqjen e të metave, shfaqjen e dobësive, shfaqjen e nevojës për pendim. Nuk ke mundësi që ta kuptosh drejt nevojën për falje gjynahesh nga Allahu ﷻ, lirim nga zjarri i Xhehenemit në Ramazan apo ndikimin e Ramazanit në faljen e mëkateve, në qoftë se këto nuk i trazon me kualitetin e duhur të adhurimeve. Atëherë dhe vetëm atëherë do të shohësh se ku qëndron.

Me shtimin e kualitetit, mund të mos kesh mundësi të ecësh, për shkak të ndonjë pengese, dhe të shohësh se sa është me rëndësi që Allahu ﷻ të ta largojë atë pengesë. Kjo është si shembulli i një njeriu i cili rri ulur dhe sipër supeve ka një pengesë të cilën nuk e vëren derisa është ulur. Ai mund të qëndrojë me orë të tëra dhe të mos e kuptojë se ka problem. Mirëpo, këtë do ta kuptojë vetëm kur të fillojë të ngrihet në këmbë. Pra, për pozitën e ulët që kemi mundemi të mos e kuptojmë kurrë barrën e mëkateve të cilat i bartim, ngase jemi mësuar me to dhe ndihemi rehat më bërjen e tyre. Atëherë kur të tentosh të ngrihesh në këmbë, çka nënkupton ngritjen e kualitetit të adhurimeve, do të shohësh se shumë ke nevojë t'i thuash Allahut ﷻ O Allah, Ti je Falës Bujar dhe e do faljen, andaj më fal!

Pra, të mos jetë më kërkimi i faljes një kërkesë e zakonshme, por një nevojë jotja. Le ta nxjerrë në shesh nevojën për kërkimin e faljes përpjekja jote për t'u ngritur.

Kemi përmendur më herët adhurimin el Unsu Bilah, që është kënaqja e njeriut në shoqëri me Allahun ﷻ ashtu sikurse kënaqet në shoqërinë e një miku të dashur të tij. Ti ende nuk ke arritur të ndihesh kështu në shoqërimin e Allahut ﷻ. Të mos ketë keqkuptime: unë nuk them se, nëse nuk arrin të ndiesh këtë kënaqësi, kjo gjendje është haram, por po e theksoj faktin se kjo është një shkallë. Selefët tanë kanë qarë, kur hynte koha e sabahut, duke e vajtuar kalimin e shpejtë të ibadetit dhe ndarjes nga shoqërimi me Allahun ﷻ.

Dikush mendon se ngritja tek Allahu ﷻ bëhet vetëm nëpërmjet kënaqjes. Kjo po që është e vërtetë pjesërisht, por ka edhe sprova drejt këtij qëllimi dhe jo çdokush mund të ngrihet lart. Ka frika të ndryshme përgjatë kësaj ngritjeje zmbropsja nga të cilat na shkakton shtresimin e të metave, të cilat vetëm vijnë duke u trashur dhe pengojnë lëvizjen e dëshiruar. Kjo ngase duke qëndruar në vend nuk e ndiejmë peshën e rëndë. Ngjashëm, vërejmë se me tempin e tanishëm të adhurimeve nuk jemi duke u lodhur, por në Ramazan, kur të mundohemi pak më shumë, shohim se na mungon forca.

Kështu, nxjerrja në shesh e të metave tona dhe njohja e forcës sonë reale bëhet vetëm nëpërmjet kualitetit të adhurimeve. Sa më kualitativ të jetë adhurimi, aq më e qartë do të dalë pasqyra e gjendjes sate.

Kjo temë është për ata që e kanë bërë njet të përballën guximshëm me faktin se kush janë në të vërtetë. Kjo është si shembulli i një njeriu i cili pëson aksident dhe merr lëndime të rënda në fytyrë dhe e ka vështirë ta shohë vetveten herën e parë pas lëndimit. Mirëpo, nuk ka zgjidhje tjetër përveçse t'i çelë sytë, se nuk mund të qëndrojnë symbyllazi, për shkak të pamundësisë për t'u ballafaquar me dhimbjen e asaj që i ka ndodhur.

Hapi sytë guximshëm dhe njihe veten tënde në këtë Ramazan përmes kualitetit të adhurimeve.

Kjo është ajo ndërlidhja mes shkakut dhe pasojës. Kualiteti i adhurimit dëshmon se ti je duke e ndier përcjelljen e Allahut ﷻ mbi ty dhe duke u ngritur kah ihsani. Sa më kualitativ të jetë rrugëtimi, aq më e sigurt do të jetë arritja.

Por, para se të fillojmë përmirësimin e kualitetit, kemi një varg nijetesh fillestare për të bërë. Sa më shumë nijete (motorë) të aktivizosh, aq më shpejtë do të mbërrish fundin. Prandaj, nuk është mirë të fiket ndonjë motor përdërisa je duke fluturuar. Besimtari mund që në një punë të bëjë një apo dhjetë nijete. Sa më shumë nijete të bëhen, aq më shumë kualitet do të ketë vepra.

E lusim Allahun ﷻ që të na japë jetë dhe shëndet për ta arritur dhe kaluar Ramazanin si duhet, por kësaj radhe me një kualitet më të lartë, që t'i arrijmë synimet që i përmendëm.

SI TA RUAJMË KUALITETIN E RAMAZANIT

Kemi përmendur më herët se më parësor është shtimi i kualitetit të veprave sesa sasia e tyre. Edhe pse sasia e garanton kualitetin dhe nuk ka mundësi të ketë kualitet në mungesë të sasisë, synimi ynë kryesor nuk duhet të jetë sasia, por kualiteti e adhurimeve.

Pra dyshim, ky kualitet sfidohet për çdo Ramazan me anë të një grumbulli veprash të cilat synojmë t'i kryejmë në Ramazan. Kështu, para se të përcaktojmë çfarëdo plani për Ramazan, duhet ta kemi plotësisht të qartë çfarë duam të arrijmë dhe të kuptojmë se ajo nuk mund të realizohet pa një adhurim kualitativ. Pra, kjo (adhurimi & kualiteti) është një lidhje e domosdoshme të cilën duhet ta kemi parasysh.

Për ta mbajtur të aktivizuar dhe për ta shtyrë përpara këtë kualitet duhen motorë. Kjo meqë, zakonisht, në javën e parë të veprimit (adhurimit) ka kualitet, por pastaj fillon të bjerë intensiteti apo të fiken motorët një nga një, çka pamundëson aterrimin tonë të suksesshëm në fund të Ramazanit. Që të mbetemi të motivuar vazhdimisht, këta motorë (motive) duhet të mbeten të ndezur. Veç kësaj, sa më tepër motive të ketë dhe sa më të fuqishme të jenë ato, aq më i sigurt do të jetë udhëtimi dhe përparimi. Krejt kjo pritet të ndikojë pozitivisht në kualitetin dhe në rezultatin që e sjellë ky kualitet.

Kur kemi të bëjmë me motivet, shpeshherë kemi përmendur se besimtari duhet të jetë mjeshtër i fitimit të sevapeve. Kjo mjeshtri e besimtarit merr formë të ndryshme dhe kryesorja është aftësia e tij për të lidhur disa motive me një punë, me qëllim që të përfitohet nga shumë aspekte.

Problemi ynë sot është se ne nuk qëndrojmë mirë me nijetin/qëllimin. Këtu nuk mendoj në atë se a kemi nijet për Allahun, por mendoj në shtimin e motiveve për një punë të vetme. Pasi po jepet munda dhe po bëhet angazhimi, pse të mos shtohen vlerat me anë të motiveve që ti ke karshi punëve. Për shembull, me ardhjen në ligjëratë kemi si motiv mësimin për Allahun ﷻ, mirëpo këtu mund të integrohen edhe, ta zëmë, pesëmbëdhjetë motive të tjera. Kështu, ti bën të njëjtën punë, pa shtuar ndonjë angazhim tjetër, por fiton shumë më shumë. Kjo i bie të bësh tregti me Allahun ﷻ dhe kjo ka mjeshtëritë dhe aftësitë e veta. Për këtë arsye, të Parët tanë (Selefët) thoshin se dijetarët e umetit ua kanë kaluar të tjerëve me motiv më tepër sesa me punë. Ata dinin të integronin disa motive në një punë, andaj dhe bënë punë më kualitative sesa të tjerët, edhe pse puna si aktivitet ishte e njëjtë si e të tjerëve.

Nëpërmjet kësaj, ne po prezantojmë një lloj strategjie të përgjithshme për motivet apo shkakun dhe pasojën. Pra, ka një shkak/motiv, që në këtë rast është kualiteti i cili sjell rezultatet e përmendura.

Si duhet të motivohet tërë kjo?

Motivi i parë duhet të jetë përgjigjja në kërkesën e Allahut ﷻ për të realizuar kualitetin e adhurimeve dha angazhimit në Ramazan. Pra, Allahu ﷻ kërkon nga ne një adhurim kualitativ. Kjo kërkesë na shfaqet kudo në Kuran, por në këtë rast mund ta veçojmë ajetin:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ ۖ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾

“O ju që besuat, kini frikë Allahun dhe secili le të shikojë se çka ka bërë gati për nesër (nga punët). Dhe kini frikë Allahun, se vërtet Allahu është i mirinformuar për atë që punoni”. (el-Hashr, 18)

Këtu gjenden tri gjërat të cilat u përmendën më lart. Së pari, devotshmëria apo frika ndaj Allahut. Termi **takva** përkthehet si devotshmëri dhe përcjell kuptimin gjuhësor të termit, por jo dhe kuptimin konceptual. Takva, sipas shpjegimit më të shpejtë të mundshëm, është izolimi që ti i bën vetes sate nga Zjarri.

Atëherë, a duhet të jetë ky izolim kualitativ, apo jo? Kjo varet nga ajo çfarë ti mbron. Në vendet e nxehta, ku nuk ka borë e as të ftohtë, izolimi që bëjnë njerëzit nuk është i ndonjë kualiteti të lartë. Mirëpo, izolimi ku ne jetojmë duhet patjetër të jetë i mirë. Pra, kjo është një thirrje për kualitet të izolimit nga Zjarri i Xhehenemit. Prej nesh kërkohet t'i frikësohemi Allahut ﷻ duke vendosur pengesa kualitative ndaj Zjarrit. Po si ta bëjmë këtë, o Zot?

Secili le të shikojë se çka ka bërë gati për nesër (nga punët). Shprehja “çfarë” në këtë ajet nënkupton edhe sasinë, edhe kualitetin. Shiko namazin që ti po ia dërgon Allahut ﷻ, me të cilin shpreson të mbrohesh nga Xhehenemi: a është qëndrueshmëria e tij e mjaftueshme për të të mbrojtur? Pastaj dhikri (leximi, meditimi) i Kuranit, e kështu me radhë.

Allahu ﷻ po kërkon prej teje të kujdesesh për kualitetin e izolimit i cili të mbron nga Xhehenemi. Ky, pra, është një motiv që të vë në lëvizje, një motor i rëndësishëm. Paramendo të kesh një paraqitje në gjykatë dhe të të jetë caktuar një gjyqtar i cili është shumë i interesuar që të fitosh në fund të procesit gjyqësor. Ky gjyqtar nuk ka mundësi të bëjë padrejtësi duke të liruar nga obligimi i paraqitjes në gjykatë, mirëpo të sugjeron përgatitjen e çështjeve të caktuara; për shembull, të udhëzon si të sigurosh një dokument dhe një avokat. Ai do t'i marrë parasysh këto?

Apo, ta zëmë, të shkosh në komunë për dokumentin dhe të shohësh një rend të gjatë të njerëzve që presin dhe menjëherë të heqësh dorë dhe të kthehesh në shtëpi. A do të veproje kështu? Natyrisht që jo, meqë i ke mendtë te momenti i pranimit të dokumentit dhe s'do ta përjetosh si të vështirë pritjen në rend. Dhe motivi që të bën të presësh në rend për orë të tëra, është garancia e suksesit që gjyqtari të ka dhënë, nëse ti sjell dokumentin e kërkuar.

Po ashtu edhe puna e avokatit: kur të kërkosht avokatin e sugjeruar, ndoshta mund të gjesh disa avokatë të tjerë me çmim më të ulët, mirëpo gjyqtari e ka kërkuar vetëm atë të cilin ta sugjeroi vetë ai, për shkak të njohurive që ai avokat ka lidhur me rastin. A do ta kontestojë çmimin e atij avokati? Natyrisht që jo, meqë për ty është e rëndësishme ta kalosh me sukses procesin gjyqësor, i cili mund të jetë vendimtar në jetën tënde.

Andaj, kujdesu për kualitetin e izolimit, në mënyrë që, kur ta vendosësh, të mos ketë rrjedhje. Vetëm për këtë ti duhet të kujdesesh, ndërsa të tjerat do t'i kryejë dikush tjetër (Allahu ﷻ). Mirëpo, duhet t'i kushtosh vëmendje kualitetit në tërë këtë.

Ky motiv mjafton për të të mbajtur në lëvizje gjithmonë, ndërsa vetë motivi mbahet gjallë me anë të vetë-llogaritjes së vazhdueshme që personi bën, siç mund të jenë pyetjet verifikuese: “A ishte ky izolim i mirë?”, “Si ishte kualiteti i tij?”, etj. Një njeri i cili blen gjëra me vlerë, nuk përtan t'i verifikojë pjesët e tyre një nga një, edhe nëse ato janë të shumta. Për shembull, ti blen njëmijë telefona të shtrenjtë për t'i shitur dhe ke një javë kohë për t'i verifikuar për defektet e mundshme, pas çka ti do të marrësh përgjegjësinë për kualitetin e secilit telefon. A do të ngurroje të provojë të gjithë telefonat një nga një? Natyrisht që jo.

Njësoj edhe Allahu ﷻ të njofton se po ta mundëson kryerjen e një vepre, kështu që duhet ta verifikosh mirë se si po ia dërgon Atij. Ti mund ta dërgosh veprën sido, por vlerën saj do ta përcaktojë kualiteti i bërjes së saj. Andaj, si përgjigje në kërkesën e Allahut ﷻ për veprat kualitative, duhet të kujdesesh ta zbatosh këtë kualitet. Kur ta kesh këtë motiv, sigurisht që namazi, agjërimi dhe shumë adhurime të tjera do të nisin të jenë më ndryshe. Dhe ky motiv aktivizohet duke verifikuar veprat një nga një.

Veç tjerash, të Parët tanë i kanë kushtuar shumë vëmendje vetë-llogaritjes, gjë që kemi përmendur te mësimi i emrave të Allahut ﷻ el-Hasiib dhe er-Rrekiib, të cilët kanë të bëjnë me llogaritjen dhe kujdesin e besimtarit për veten e tij. Ky, pra, është motivi i parë.

Motivi i dytë që duhet ta kemi parasysh është motivi për t'u penduar dhe për të përtëritur marrëveshjen me Allahun ﷻ. Kjo meqë në çdo Ramazan ne bëjmë marrëveshje me Allahun ﷻ pastaj e prishim atë. Bëjmë marrëveshje duke i premtuar Allahut ﷻ se do të jemi më të mirë, por në fund nuk del as afërsisht ashtu siç llogarisim. Kështu, kësaj radhe kije si motiv një marrëveshje të re mes teje dhe Allahut, duke u penduar për marrëveshjet e shkelura dhe të pazbatuara në të kaluarën, ndërsa sinqeritetin për këtë mundohu ta dëshmosh me kualitetin e adhurimeve.

Dikush bën shkelje të vazhdueshme dhe, kur të vijë koha e dënimit të tij, ai zotohet se në të ardhmen do të jetë më i mirë. Të këtitillit, natyrisht, është vështirë t'i zësh besë, pasi me dhjetëra herë ka kryer të njëjtën shkelje, si ai bariu gënjeshtar, i cili gënjente fshatarët për ujkun, derisa ujku u shfaq përnjëmend dhe askush s'i besonte bariut.

Edhe në kohën e peygamberit ﷺ pati njerëz që iu betuan Allahut ﷻ se, në qoftë se Ai do t'u jepte pasuri, ata do të jepnin lëmoshë. Allahu ﷻ u dha atyre pasurinë që kërkuan, por ata thyen zotimin, kështu që, siç tregohet në Kuran, Allahu ﷻ ua mbushi zemrat me nifak (shtirje). Kjo sepse nijeti i tyre s'ishte i sinqertë, kualiteti i veprës së tyre ishte kualitet shtinjakësh, andaj Allahu ﷻ ua vulosi zemrat për të bërë punë sa për sy e faqe.

وَمِنْهُمْ مَّنْ عَاهَدَ اللَّهَ لَئِنْ آتَانَا مِنْ فَضْلِهِ لَنَصَّدَّقَنَّ وَلَنَكُونَنَّ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٧٥﴾ فَلَمَّا آتَاهُمْ مِّنْ فَضْلِهِ بَخِلُوا بِهِ وَتَوَلَّوْا وَهُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿٧٦﴾ فَأَعَقَبَهُمُ نِفَاقٌ فِي قُلُوبِهِمْ إِلَى يَوْمِ يَلْقَوْنَهُ بِمَا أَخْلَفُوا اللَّهَ مَا وَعَدُوهُ وَبِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ ﴿٧٧﴾ أَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ سِرَّهُمْ وَنَجْوَاهُمْ وَأَنَّ اللَّهَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ ﴿٧٨﴾

“E prej tyre (hipokritëve) pati sish që i patën dhënë besën Allahut që: “Nëse na jep (Allahu) nga mirësia e Tij, ne do të ndajmë lëmoshë dhe do të bëhemi prej punëmirëve”. Kur ju dha (Allahu) nga të mirat e Veta, ata bënë kopranci me atë (që u dha), e thyen besën dhe u zbrapsën nga respekti ndaj Allahut.

Dhe për shkak se e thyen besën që i patën dhënë Allahut, dhe për shkak të asaj se gënjenin, Allahu u ngjeshi hipokrizinë në zemrat e tyre deri në ditën që e takojnë Atë.

A nuk e ditën ata se Allahu e di fshehtësinë e tyre (në zemra), bisedën e tyre, dhe se Ai (Allahu) i di të gjitha të fshehtat”. (Teube 75-78)

Po ashtu, kemi rastin e mosdaljes në ekspeditën e Tebukut dhe arsyetimet e rreme të personave të përfshirë, të cilat Allahu ﷻ nuk ua pranoi dhe i përgënjeshtroi në Kuran, duke e lidhur mosdaljen e tyre me mospasje të nijetit të sinqertë për dalje. Ky është një fakt tmerrues, meqë personat për të cilët po flitet qenë njerëz që jetuan në kohën e peygamberit ﷺ dhe për ta Allahu tha në Kuran:

وَلَوْ أَرَادُوا الْخُرُوجَ لَأَعَدُّوا لَهُ عُدَّةً وَلَكِنْ كَرِهَ اللَّهُ انْبِعَاثَهُمْ فَثَبَّطَهُمْ وَقِيلَ اقْعُدُوا مَعَ الْقَاعِدِينَ

“Po të donin të dilnin (për luftë), do të bënin ndonjë përgatitje, por Allahu e urreu daljen e tyre, andaj i zmbrapsi dhe iu tha atyre: ‘Rrini me të paaftit (fëmijët, gratë e pleqtë)’”. (et-Teube, 46)

“Allahu e urreu daljen e tyre”, domethënë e urreu lëvizjen e tyre të rrejshme, pa kualitet, dhe me nijet të ulët.

Kur të vësh se po të bie kualiteti i veprave, kujtoja vetvetes këtë motiv dhe futi vetës frikën se mos nuk do të të zihet besë as ty herëve të tjera. Sa më aktiv që të jetë ky motiv, aq më tepër do të reflektojë në përmirësimin e kualitetit. Ky motiv do të reflektojë fisnikëri në bërjen e veprave, përndryshe, në qoftë se nuk zbatohet, mund të shndërrohet në punë sa për sy e faqe që të rëndon e s'të lë të veprosht.

Theksimi i rëndësisë së këtij motivi nuk po bëhet për të të dekurajuar, por për të nxitur të lartësohesh, ngase, kur të lartësohesh, do të kesh hyrë në adhurim tashmë. Kjo është si shembulli i fluturimit me aeroplan, kur nuk guxon ta ndalësh shpejtësinë pasi të ngjitesh lart, ngaqë rrethanat e kërkojnë një shpejtësi të tillë dhe ulja e shpejtësisë do të ishte fatale. Kështu është edhe ecja drejt Allahut ﷻ. Pra, kësaj radhe kije si motiv një marrëveshje të re me Allahun ﷻ duke i prishur marrëveshjet e kaluara, të cilat nuk janë nisur si duhet. Mirëpo, tash po e di rregullin: sa herë të të shkojë ndër mend ta ulësh kualitetin, kujto zotimin që dhe.

Për arrijten e disa gjërave nuk ke nevojë të bësh përgatitje të veçantë, por, nëse dëshiron të mbërrish më shpejtë, duhet të respektosh rregulla të caktuara. Për disa ambicie të ulëta të njerëzve nuk ka nevojë për Ramazanin ku pazari është i lartë dhe ofrohet shumë. Në këtë kontekst, Hasan el-Basri tha: **“Disa njerëzve nuk u duhet gjë koha. Sikur të kisha mundësi t’ua blija atë, do të shitja gjithë çfarë kam për t’ua blerë”.**

Pra, ka njerëz të cilëve nuk u duhet Ramazani fare, sepse nuk kanë kurrfarë synimi. Ato gjëra që i synojnë shumë njerëz në Ramazan, ka mundësi të arrihen edhe pa Ramazan. Dhe gjithmonë jam duke folur për atë që realisht ofron Ramazani prej lartësirave të tij.

Motivi i tretë ka të bëjë me luftimin e sëmundjes së quajtur **gaflet/huti/shkujdesje**, e cila reflektohet në dy aspekte. Aspekti i parë reflekton mungesën e veprës. Nga gafleti, ti harron se duhet të bësh një veprë siç është dhikri. Ti mund ta kryesh veprën, mirëpo e bën këtë i shkujdesur. Ti mund të falësh namaz dhe të mos mund të thuhet se nuk je falur, mirëpo sa përfiton nga ai namaz? Apo të bësh dhikrin e mëngjesit dhe të mbrëmjes, ku 70% apo 90% nuk e di çfarë po thuhet. Pra, në këtë Ramazan kije si motiv ta luftosh gafletin. Mundohu që së paku një muaj të mos tregohesh i shkujdesur. Rrjedhimisht, kur mposhtet shkujdesja, vjen kualiteti, meqë këto dyja e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Në momentin kur ndien se po të rrezikohet kualiteti nga shkujdesja, kujtoje motivin për të mos qenë i shkujdesur më. Ky përkujtim e garanton automatikisht zhvillimin e kualitetit. Për një ndikim më të madh, shkruaj motivin dhe shikojë çdo mëngjes. Është më ndryshe, kur ta shohësh të shkruar motivin që të shtyn të veprosht. Këtu nuk po mendoj në të shkruarit e nijetit sheriatik, meqë ky nijet nënkuptohet nga zgjimi yt për syfry. Nijeti për kryerjen e një adhurimi nuk ka nevojë të shkruhet apo të thuhet. Por, këtu bëhet fjalë për motivin për adhurim, i cili bën të shkruhet.

Te Selefët gaflet/shkujdesja ishte si e një shtrese pluhuri, që është larguar me një të fryrë. Te ne gafleti është shtresëtrashë dhe lypet goxha punë e madhe për ta larguar atë. Dikush ka nevojë vetëm për një përkujtim, dikush ka nevojë që ta ketë të shkruar dhe për tridhjetë ditë t'ia lexojë vetes së tij. Krejt kjo thamë së është për të garantuar kualitet, jo për të garantuar bërjen e veprës, ngase veprat pritet të bëhen patjetër, in sha Allah.

Mundohu që adhurimet të cilat i ke bërë vitin e kaluar t'i bësh edhe këtë vit, veçse pa gaflet. Unë nuk e di kush sa ka bërë vitin e kaluar, por shpresoj se në aspektin sasior qëndrojmë mirë. Pra, mundohu që të gjitha ato t'i bësh pa gaflet, duke u bërë më i vëmendshëm ndaj kuptimeve, duke inkadruar edhe zemrën në ato adhurime.

Le të jetë motoja e Ramazanit tënd: adhurim pa gaflet, adhurim me më shumë vëmendje, adhurim me një përkushtim më të madh. Bëji vetes pyetje për secilin adhurim që e bën në Ramazan se si po e bën: me gaflet, apo pa gaflet.

Ky dhe motivet e tjera, siç thamë më lart, janë motorët e besimitarit, të cilët e garantojnë kualitetin deri në fund, në qoftë se janë të pranishëm dhe të fuqishëm që në fillim.

Motivi i katërt që është mirë të kihet është motivi për të kompensuar humbjet e së kaluarës. Nëse ke humbur në të kaluarën nga koha, aktiviteti, sasia, atëherë kompensoji në këtë Ramazan. Ka një rregull të cilin e kanë përmendur dijetarët dhe i cili është nxjerrë nga argumentet e Sheriatit, të cilin e shprehu dhe Fudejl Ibn Ijadi, ku thuhet: “Përmirësoje atë që të ka mbetur, të falet ajo që ka kaluar”.

Pra, kualiteti i këtij Ramazani mund të ta garantojë faljen nga Allahu ﷻ të mungesës së kualiteti në të kaluarën. Kije si motiv ta përmirësosh kualitetin e Ramazanave të kaluar me kualitetin e këtij Ramazani. Ndoshta, krejt çfarë na ka mbetur mua dhe ty, vëlla i dashur, është vetëm edhe ky Ramazan. Ndoshta, ky është Ramazani i fundit që të përmirësosh të kaluarën. Prandaj, le të jetë aktiv ky motiv te ne, meqë nuk është me vend të vajtojmë atë që ka shkuar e t'u hapim derën vesveseve e të humbasim kurajën, pasi Allahu ﷻ po na e mundëson arritjen edhe të këtij Ramazani. Domethënë, arritja e këtij Ramazani duhet të na stimulojë, por kësaj radhe më ndryshe. Këtë herë syno kualitetin dhe shpresoj që, me motivin për kualitet në këtë Ramazan, të të plotësohet mungesa e kualitetit të Ramazanave të kaluar.

Kjo vërtet është e mundshme sheriatikisht, meqë ka ndodhur që njerëzit, me një fjalë kualitative, ta pastrojnë tërë bërllokun të cilin e kanë mbledhur gjatë jetës së tyre. Sigurisht keni dëgjuar për rastin e personit i cili u vra në betejën e Uhudit. Ai erdhi për të luftuar kundër pejgamberit ﷺ, por e tha shehadetin dhe u kthye për t'i luftuar mushkrikët.

Enes Ibn Malik tha se nuk di për ndonjë njeri të jetë futur në Xhenet pa falur namaz dhe pa bërë ndonjë punë tjetër, përveç këtij. Dhe a ka vepër më të ndyrë sesa të jesh kundërshtar i pejgamberit ﷺ !

Por, tërë këtë periudhë të zymtë, të nxirë, të jetës së tij ai e zbardhi me një qëndrim të duhur, në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur. Pra, ky është ai motivi për të cilin po flasim: motivi për të qenë ndryshe, për të kompensuar të kaluarën.

Kur njeriu të ndryshojë më një fjalë, çfarë ta merr mendja se mund të bëhet me një Ramazan? Një Ramazan është i mjaftueshëm për ta bërë më të mirë edhe të kaluarën, edhe të ardhmen e jetës. Kështu qenë edhe Selefët. Ata nuk ankoheshin, kur mund të vepronin. Në dritën e kësaj, Katade tha se në të kaluarën kishte shtirje për veprat që bëheshin, kurse sot ka shtirje, edhe pse mungojnë veprat. Pra, më herët njerëzit kishin probleme me shtirjen që mund t'u shfaqej për shkak të veprave të mira që bënin, kurse sot mund të shohësh njerëz të lavdërohen, edhe pse nuk bëjnë gjë. Dhe shtirja pa vepra është kombinimi më i keq i mundshëm.

Në qoftë se kualiteti i këtij Ramazani ngrihet dhe pranohet nga Allahu ﷻ dhe ti vdes, tek Allahu do të gjykoresh sipas veprës së fundit që ke bërë. Kjo është një mirësi e pamasë e Allahut ﷻ ndaj besimtarëve. Domethënë, nga mirësia e Allahut ﷻ është se, në qoftë se besimtari përpiket për kualitet, Allahu ﷻ e gjykon atë në bazë të veprës së fundit që ai e bën në këtë udhëtim. Mund të kenë kaluar njëzet Ramazana me kualitet të diskutueshëm, madje edhe pa kualitet fare, dhe ky Ramazan mund të jetë i fundit dhe vendimtar për tërë Ramazanat e kaluar. Pra, ti vendos se a dëshiron t'i kesh edhe njëzet Ramazana të tjerë kualitativ sikurse ky, apo të rëndohesh edhe me një tjetër Ramazan jokualitativ krahas njëzet të tjerëve.

Edhe pse këtu ka ende për t'u thënë, mendoj se pikat që i përmendëm deri më tani janë të domosdoshme dhe vendimtare për të arritur me lejen e Allahut ﷻ pozitën e dëshiruar gjatë Ramazanit dhe pas tij. Me këto motive, me lejen e Allahut ﷻ, besoj se do të jemi në rrugën e duhur drejt një Ramazani më kualitativ.

Shumë gjëra e ndodhi mund të mos na kujtohen. Ne, madje, mund të harrojmë si jemi falur para pesë apo gjashtë muajsh, kështu që një formular apo fletanketë që do të na i rikujtonte stacionet e vitit të kaluar mund të jetë mjaftë i rëndësishëm në këtë rast. Kështu, pas një konsultimi me përvojat e dijetarëve dhe shkrimet e tyre, kam përpiluar një përmbledhje pyetje-përgjigjesh, e cila shpresoj se do të pasqyrojë gjendjen tonë sa më realisht, me qellim që te përcaktojmë drejtimin e rregullimit tonë. Bëhet fjalë për formularin me 15 pyetje në vijim:

FLETANKETA

VËREJTJE: Të lusim që nga pyetjet në vijim të zgjedhësh përgjigjen që përshkruan saktë ose më së afërti gjendjen tënde.

1. Si i ke qëndruar llogaritjes së vetvetes vitin që kaloi? (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. E kam bërë shpesh (çdo dite, çdo javë)
- b. E kam bërë në rast fatkeqësie
- c. E kam bërë rrallëherë (një apo dy herë gjatë vitit)

2. Si e vlerëson rezistencën tënde ndaj kërkesave të epshit? (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Të qëndrueshme
- b. Nganjëherë kam bërë lëshime
- c. Shpesh kam bërë lëshime

3. Cilat kanë qenë prioritetet tua vitin që po e lë pas? (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. U kam dhënë përparësi çështjeve të Ahiretit ndaj çështjeve të kësaj bote
- b. U kam dhënë përparësi çështjeve të kësaj bote ndaj çështjeve të Ahiretit
- c. Kam qenë i preokupuar me gjendjet e të tjerëve
(vlerësimin e tyre, të folurit për gabimet e tyre, etj).

4. Për çfarë ndien keqardhje më së shumti? (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Për kohën e pashfrytëzuar në fitim të shpërblimit (adhurime dhe bamirësi)
- b. Për shanset e humbura në biznes apo fitim material
- c. Për mosbërje të vizitave

5. Si e vlerëson sjelljen dhe moralin tënd për dallim nga viti i kaluar? (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Ka ndryshuar në të mirë
- b. Nuk vërej ndonjë ndryshim
- c. Gjendjen e kam më keq se vitin e kaluar (jam më arrogant, me i ngutshëm, me paragjykes, etj)

6. Si të ka kaluar viti që shkoi ... : (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Sipas planifikimit dhe organizimit që ke bërë
- b. Spontanisht, sipas rrethanave dhe situatës

7. Si e vlerëson përpjekjen tënde për të mbajtur nën kontroll gjymtyrët në vijim? (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

Gjuhën:

- ☐ Të suksesshme
- ☐ Të dështuar

Shikimin:

- ☐ Të suksesshme
- ☐ Të dështuar

Dëgjimin:

- ☐ Të suksesshme
- ☐ Të dështuar

8. Si e vlerëson përmbushjen tënde të detyrave ndaj:

Prindërve:

- ☐ Përmirësim
- ☐ Përkeqësim

Bashkëshortes/bashkëshortit:

- ☐ Përmirësim
- ☐ Përkeqësim

Fëmijëve:

- ☐ Përmirësim
- ☐ Përkeqësim

Punës me të cilën je i ngarkuar:

- ☐ Përmirësim
- ☐ Përkeqësim

Farefisit:

- ☐ Përmirësim
- ☐ Përkeqësim

9. Si është gjendja e dhembshurisë sate ndaj pësimeve të ummetit (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Në rritje
- b. E zakonshme
- c. Nuk jam preokupuar me këtë çështje

10. Adhurimet tua janë shtuar në: (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Sasi dhe kualitet
- b. Sasi
- c. Kualitet
- d. S'ka pasur kurrfarë shtimi

11. Si është qëndrimi yt sa i përket vdekjes dhe daljes para Allahut: (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Bëj përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e vetvetes
- b. Do të dëshiroja që jeta të më përfundonte kur isha në gjendje devotshmërie më të mirë.
- c. Nuk bëj ndonjë përgatitje të veçantë.

12. Ku qëndroni me përgatitjet për Ramazanin e radhës: (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Kam filluar më herët se vitin e kaluar
- b. Kam filluar më vonë se vitin e kaluar
- c. Nuk kam filluar ende

13. Në këtë Ramazan do t'i kushtosh më tepër rëndësi: (rrumbullako vetëm njërën përgjigje):

- a. Kualitetit të adhurimeve
- b. Sasisë së adhurimeve
- c. Nuk jam përcaktuar ende

14. A ke vepra të caktuara për të cilat mendon të pendohesh në këtë Ramazan?

- a. Mendoj të pendohem për cilësinë e dobët të adhurimeve
- b. Mendoj të pendohem për ndonjë vepër të ndaluar
- c. Mendoj të kërkoj falje të përgjithshme

15. Përmendi tri arsye për të cilat mendon se këtë Ramazan do ta kalosh më mirë se Ramazaneve të kaluar

- 1. _____
- 2. _____
- 3. _____

